



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren
Prizren Belediyesi

Drejtoria për Buxhet dhe Financa

RAPORT KRAHASUES I SHPENZIMEVE 2023-2025

Raport krahasues i shpenzimeve për Komunën e Prizrenit për vitet 2023, 2024 dhe 2025 për kategoritë:

- Paga
- Mallra & Shërbime
- Shpenzime Komunale
- Subvencione
- Investimeve Kapitale

Prizren, shkurt 2026

HYRJE

Në këtë raport financiar është paraqitur niveli i shpenzimeve sipas kategorive për Komunën e Prizrenit për tri vitet paraprake 2025, 2024 dhe 2023 duke i krahasuar në mes këtyre viteve shpenzimet e ndodhura.


Janë krahasuar shpenzimet për: Paga, Mallra&Shërbime, Shpenzime komunale, Shpenzime kapitale dhe Subvencione për vitet 2023, 2024 dhe 2025.

- Shpenzimet në kategorinë e pagave në vitin 2025 ishin për 8.71% më të larta se në vitin 2024 dhe rreth 15.95% më shumë se në vitin 2023, pra është një trend i rritjes së shpenzimeve në kategorinë e pagave.
- Shpenzimet në kategorinë e mallra&shërbime në vitin 2025 ishin më të larta për 13.75% se në vitin 2024 dhe 21% më të larta se në vitin 2023. Edhe tek kjo kategori e shpenzimeve kemi rritje të vazhdueshme në raport me vitet paraprake.
- Shpenzimet në kategorinë “Shpenzime Komunale (Komunalitë) në vitin 2025 ishin më të larta për 30.26% në krahasim me vitin 2024, ndërsa krahasuar me vitin 2023 këto shpenzime ishin ulur për 30.90% në vitin 2025. Tek ky lloj i shpenzimit shihet një lëvizje nga viti në vit, pra nuk ka një rritje apo ulje të vazhdueshme nga viti në vit, por janë shpenzime të paparashikueshme dhe mund të ndryshojnë në secilin vit.
- Shpenzimet në kategorinë e subvencioneve në vitin 2025 ishin për 14.64% më të larta se në vitin 2024, ndërsa krahasuar me vitin 2023 shpenzimet për subvencione ishin dukshëm më të larta apo rreth 34.45% më shumë në vitin 2025.
- Shpenzimet në kategorinë e Investimeve kapitale, në vitin 2025 ishin më të ulëta për 3.5% krahasuar me vitin paraprak 2024 dhe rreth 19.73% më të larta krahasuar me vitin 2023.

Ajo që duhet theksuar nga të dhënat në këtë raport vërejmë se në kategorinë e shpenzimeve për subvencione kemi rritje të vazhdueshme të shpenzimeve e cila është një indikatorë së qeverisja komunale vazhdimisht rrit shpenzimet të cilat prekin individë dhe OJQ të cilat përfitojnë fonde publike, po ashtu shpenzimet janë rritur edhe në kategorinë e Investimeve Kapitale përveç në vitin 2025 ku kemi një zvogëlim të këtyre shpenzimeve në raport me vitin 2024 për 3.5%.


SHPENZIMET SIPAS KATEGORIVE EKONOMIKE PËR TË GJITHA DREJTORITË KOMUNALE PËR 2023, 2024 dhe 2025

DREJTORITË/ZYRET	SHPENZIMET PËR PAGA			SHPENZIMET PËR MALLRA&SHËRBIME			SHPENZIMET KOMUNALE (KOMUNALITË)			SHPENZIMET KAPITALE			SUBVENCIONET		
	2023	2024	2025	2023	2024	2025	2023	2024	2025	2023	2024	2025	2023	2024	2025
KRYETARI-ASAMBLEJA KOMUNALE	306,550	304,998	335,709	102,361	-	500,802	-	-	-	-	-	-	3,508,216	4,003,875	4,488,706
DREJTORIA E ADMINISTRATËS	477,868	492,460	576,476	1,105,301	1,015,898	1,160,214	717,953	54,654	205,547	104,862	346,437	434,580	-	-	-
DREJTORIA E INSPEKTORIATIT	186,687	198,550	216,603	60,791	66,694	79,717	-	-	-	-	-	-	-	-	-
ZYRA E KUVENDIT KOMUNAL	357,757	391,701	446,210	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
DREJTORIA PËR BUXHET DHE FINANCA	242,427	292,388	340,366	358,486	622,346	149,448	-	97,884	-	30,000	428,432	186,036	-	-	-
DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE	643,105	640,849	783,039	3,573,537	3,128,072	5,219,600	477,832	329,659	496,710	13,580,301	15,621,312	15,256,023	-	-	-
ZYRA E KOMUNITETEVE	37,433	40,378	50,186	39,335	48,907	49,999	-	-	-	-	-	-	-	-	-
DREJTORIA E BUJQËSISË	129,212	66,085	68,161	214,353	243,107	241,425	-	-	-	387,242	868,387	404,933	-	86,523	206,540
DREJTORIA E TURIZMIT DHE ZHVILLIMIT EKONOMIK	45,787	36,534	29,953	105,552	88,820	79,825	-	-	-	375,628	742,616	625,162	-	-	-
DREJTORIA E GJEODEZISË DHE KADASTRIT	120,225	127,520	144,788	21,220	21,804	20,806	-	-	-	-	-	-	-	-	-
DREJTORIA E URBANIZMIT DHE PLANIFIKIMIT	105,616	114,194	119,740	548,557	597,285	448,351	-	-	-	150,000	-	-	-	-	-
DREJTORIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT	353,674	386,595	433,299	784,802	1,261,344	1,072,525	-	-	-	1,154,706	1,363,148	1,372,443	29,750	59,000	61,785
DREJTORIA E MIRËQENIES SOCIALE	245,925	336,063	447,443	898,419	873,179	944,296	588	18,536	19,998	138,840	580,394	584,669	-	-	-
DREJTORIA E ARSIMIT	17,914,856	19,325,137	20,516,901	2,410,178	2,519,635	2,386,814	224,972	225,575	145,763	2,314,578	2,382,985	2,427,305	-	-	-
DREJTORIA E SHËNDËTËSISË	4,541,885	4,669,771	5,302,727	1,607,007	2,094,495	1,958,216	149,404	94,773	201,520	964,321	1,489,332	1,698,081	-	-	-
								-			-			-	-
GJITHSEJ	25,709,009	27,423,223	29,811,600	11,829,897	12,581,586	14,312,038	1,570,749	821,081	1,069,539	19,200,477	23,823,042	22,989,232	3,537,966	4,149,398	4,757,031



KRYETARI DHE ASAMBLEJA KOMUNALE

Shpenzimet në kategorinë e pagave, mallra&shërbime, shpenzimet komunale, subvencionet dhe investimet kapitale për 2023, 2024 dhe 2025




Shpenzimet në zyrën e Kryetarit të Komunës kanë qenë vetëm në tri kategori, atë pagave, mallra&shërbime dhe subvencioneve.

Kategoria që ka rritje të theksuar të shpenzimeve të cilat janë pjesë e zyrës së Kryetarit të Komunës janë subvencionet, ku shihet një trend i rritjes së tyre. Në vitin 2023 këto shpenzime ishin rreth 3.5 milion euro, në vitin 2024 janë rritur për 0.5 milion euro më shumë se në vitin 2023 më saktësisht rreth 4 milion euro apo 14%, ndërsa në vitin 2025 krahasuar me vitin 2023 shpenzimet për subvencione janë rritur përafërsisht 1 milion euro apo rreth 25.7% më shumë. Ndërsa në vitin 2025 krahasuar me vitin paraprak 2024 shpenzimet për subvencione ishin rritur për rreth 0.48 milion euro më shumë.

DREJTORIA E ADIMINISTRATËS

Shpenzimet në kategorinë e pagave, mallra&shërbime, shpenzimet komunale, subvencionet dhe investimet kapitale për 2023, 2024 dhe 2025




Në Drejtorinë e Administratës shpenzimet më të larta kanë qenë në kategorinë e Mallra&Shërbimeve, pastaj pagat, shpenzimet komunale dhe investimet kapitale. Në vitin 2023 shpenzimet në kategorinë e mallra&shërbimeve ishin rreth 1.1 milion euro, në vitin 2024 këto shpenzime ishin zvogëluar për 90,000 euro apo 1.01 milion euro, ndërsa në vitin 2025 këto shpenzime përsëri ishin rritur për rreth 145,000 euro më shumë dhe duke e arritur shifrën prej 1.16 milion euro

Shpenzimet në kategorinë e investimeve kapitale në vitin 2023 ishin rreth 105,000 mijë euro, në vitin 2024 këto shpenzime ishin rritur rreth 241.000 mijë euro më shumë apo rreth 230% më shumë shpenzime. Në vitin 2025 investimet kapitale kapin vlerën e rreth 434 mijë eurove apo rreth 88 mijë euro më shumë se në vitin 2024 dhe 329 mijë euro më shumë se në vitin 2023. Pra ka një rritje të lehtë të investimeve kapitale nga drejtoria e administratës në vitin 2025 krahasuar me dy vitet paraprake.

DREJTORIA E INSPEKTORIEVE

Shpenzimet në kategorinë e pagave, mallra&shërbime, shpenzimet komunale, subvencionet dhe investimet kapitale për 2023, 2024 dhe 2025




Siç shihet nga të dhënat më lartë, Drejtoria e inspektorateve në tre vitet e fundit ka pasur shpenzime vetëm në kategoritë e Pagave dhe Mallra&Shërbim.

Nga grafiku më lartë vërejmë që shpenzimet nga kategoria e pagave nga viti 2023 deri në vitin 2025 kanë pasur rritje deri në 16 % në vitin 2025, ndërsa shpenzimet nga kategoria mallra&shërbime në vitin 2024 në raport me vitin 2023 janë rritur për rreth 6 mijë euro, ndërsa në vitin 2025 janë rritur sërish për rreth 13 mijë euro krahasuar me vitin 2024.

ZYRA E KUVENDIT KOMUNAL


Shpenzimet në kategorinë e pagave, mallra&shërbime, shpenzimet komunale, subvencionet dhe investimet kapitale për 2023, 2024 dhe 2025



Zyra e Kuvendit komunal ka pasur vetëm një kategori të shpenzimeve, atë të pagave. Shpenzimet për pagat janë rritur nga viti në vit përgjatë këtyre tre viteve. Në vitin 2024 shpenzimet në kategorinë e pagave janë rritur për rreth 34 mijë euro më shumë se në vitin 2023 apo shprehur në përqindje rreth 9.48 % më shumë. Po ashtu edhe në vitin 2025 në raport me vitin 2024 ka pasur rritje të shpenzimeve për pagat për rreth 54 mijë euro më shumë apo 14% më shumë.

DREJTORIA PËR BUXHET DHE FINANCA

Shpenzimet në kategorinë e pagave, mallra&shërbime, shpenzimet komunale, subvencionet dhe investimet kapitale për 2023, 2024 dhe 2025



Sipas të dhënave të prezentuara në grafik, në Drejtorinë për Buxhet dhe Financa shpenzime ka pasur në katër kategori, atë të pagave, mallrave, shpenzimeve komunale (komunalitë) dhe investime kapitale.


Shpenzimet më të dukshme dhe me vlerë më të madhe siç edhe shihet në grafik janë ato në kategorinë Mallra&shërbime. Në vitin 2025 krahasuar me dy vitet paraprake atë 2024 dhe 2023 shpenzimet në këtë kategori ishin më të ulëta. Nëse e krahasojmë vitin 2025 me vitin paraprak 2024 shpenzimet nga kjo kategori janë zvogëluar dukshëm për 427 mijë euro apo rreth 68.75%.

Po ashtu edhe në kategorinë e pagave, shpenzimet kanë pasur rritje nga viti në vit përgjatë këtyre tre viteve të fundit 2023, 2024 dhe 2025.

Shpenzimet nga kategoria e Investimeve kapitale janë rritur dukshëm në vitin 2024 në raport me vitin 2023 rreth 400 mijë euro më shumë apo shprehur në përqindje 1328 % më shumë, mirëpo kjo ka ardhur si pasojë e pagesave për me procedura përmbartimore, ndërsa në vitin 2025 krahasuar me vitin 2024 ka rënie të shpenzimeve nga kategoria e investimeve kapitale rreth 242 mijë euro më pak.

DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE

Shpenzimet në kategorinë e pagave, mallra&shërbime, shpenzimet komunale, subvencionet dhe investimet kapitale për 2023, 2024 dhe 2025




Drejtorja e Shërbimeve Publike e Komunës së Prizrenit shpenzimet më të larta i ka në kategorinë e Investimeve kapitale e cila është e prishme duke e ditur rolin e kësaj drejtorie.

Siç shihet edhe në grafikun më lartë shpenzimet në kategorinë e Investimeve Kapitale në tri vitet e fundit 2023, 2024 dhe 2025 janë rritur në mënyrë të theksuar nga viti në vit. Në vitin 2024 në raport me vitin 2023 këto shpenzime ishin rritur për rreth 2.04 milion euro më shumë apo 15 % më shumë, ndërsa në vitin 2025 investimet kapitale ishin zvogëluar për rreth 365 mijë euro më pak së në vitin 2024 apo rreth 2.3% më pak. Po ashtu në vitin 2025 investimet kapitale ishin më të larta edhe nga viti 2023 për rreth 1.6/ milion euro apo rreth 12.4 % më shumë investime kapitale.

Kategori tjetër e shpenzimeve e cila ka vlera relativisht të larta janë Mallra&Shërbimet, shpenzime këto të cilat kanë pësuar luhatje në tri vitet e fundit siç edhe shihet në grafikun e paraqitur.

ZYRA E KOMUNITETEVE

Shpenzimet në kategorinë e pagave, mallra&shërbime, shpenzimet komunale, subvencionet dhe investimet kapitale për 2023, 2024 dhe 2025




Në zyrën e komuniteteve gjatë tri viteve të fundit ka pasur shpenzime vetëm në dy kategori, atë të pagave dhe mallra&shërbimeve.

Shpenzimet në kategorinë e pagave janë rritur nga viti në vit, nëse e krahasojmë vitin 2025 me dy vitet paraprake atë 2024 dhe 2023 shpenzimet e pagave janë rritur me rreth 13 mijë euro apo shprehur në përqindje rreth 34 % me vitin 2023 dhe rreth 10 mijë euro me vitin 2024 apo 24.3% përafërsisht. Po ashtu edhe shpenzimet në kategorinë mallra&shërbime janë rritur përgjatë tre viteve të fundit. Në vitin 2025 këto shpenzime ishin më të larta krahasuar me dy vitet paraprake 2024 dhe 2023, rreth 10 mijë euro më shumë se në vitin 2023 dhe rreth 1 mijë euro më shumë se në vitin 2024.

DREJTORIA E BUJQËSISË

Shpenzimet në kategorinë e pagave, mallra&shërbime, shpenzimet komunale, subvencionet dhe investimet kapitale për 2023, 2024 dhe 2025




Në shpenzimet e Drejtorisë së Bujqësisë ajo që vihet re më shumë janë dy kategori e shpenzimeve, Subvencionet dhe Investimet kapitale.

Në kategorinë e Investimeve kapitale shihet lëvizje jo konstante në këto 3 vit. Në vitin 2024 këto shpenzime ishin rritur për rreth 480 mijë euro më shumë se në vitin 2023 ndërsa në vitin 2025 ka një zvogëlim prej rreth 460 mijë euro në raport me vitin 2024.

Po ashtu ajo që vërehet nga grafiku i shpenzimeve në këtë drejtori janë edhe subvencionet, ku në vitin 2024 ato ishin 206,50, ndërsa në vitin 2023 këto shpenzime ishin dukshëm më të ulta me rreth 86 mijë euro.

DREJTORIA E TURIZMIT DHE ZHVILLIMIT EKONOMIK

Shpenzimet në kategorinë e pagave, mallra&shërbime, shpenzimet komunale, subvencionet dhe investimet kapitale për 2023, 2024 dhe 2025




Në Drejtorinë e Turizmit dhe zhvillimit ekonomik ajo që bie më shumë në sy janë shpenzimet për investime kapitale të cilat janë rritur rreth 366 mijë euro më shumë në vitin 2024 krahasuar me atë 2023. Në vitin 2025 shpenzimet nga kjo kategori në raport me vitin 2024 janë zvogëluar për rreth 117 mijë euro apo rreth 15.80% më pak.

Shpenzimet në kategorinë e pagave në vitin 2025 kanë qenë më të ulëta për rreth 6 mijë euro se në vitin 2024.

DREJTORIA E GJEODEZISË DHE KADASTRIT

Shpenzimet në kategorinë e pagave, mallra&shërbime, shpenzimet komunale, subvencionet dhe investimet kapitale për 2023, 2024 dhe 2025




Në Drejtorinë e Gjodezisë dhe Kadastrit janë vetëm dy kategori të shpenzimeve, ajo e pagave dhe mallra&shërbimeve.

Nga të dhënat në grafikun më lartë, shpenzimet e pagave janë rritur vazhdimisht nga viti 2023 deri në atë 2025. Në vitin 2025 shpenzimet për paga ishin për rreth 17 mijë euro më shumë se në vitin 2024 dhe rreth 24 mijë euro më shumë se në vitin 2023. Kjo mund të ketë ndodhur nga shumë faktorë siç janë rekrutimi apo ndryshimet në paga etj. Shpenzimet për mallra&shërbime në të tre vitet e fundit 2023 dhe 2024 dhe 2025 ato ishin pothuajse konstante duke mos pësuar shumë ndryshime të dukshme.

DREJTORIA E URBANIZMIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR


Shpenzimet në kategorinë e pagave, mallra&shërbime, shpenzimet komunale, subvencionet dhe investimet kapitale për 2023, 2024 dhe 2025



Shpenzimet më të mëdha në Drejtorinë e Urbanizmit përgjatë tre viteve të fundit ishin në kategorinë e Mallra&Shërbimeve. Nëse e krahasojmë vitin 2024 me vitin 2023, shpenzimet në këtë kategori ishin rritur për rreth 48 mijë euro më shumë. Ndërsa në vitin 2025 këto shpenzime në raport me vitin 2024 këto shpenzime ishin zvogëluar për rreth 149 mijë euro. Po ashtu shpenzimet në kategorinë e investimeve kapitale ka pasur vetëm në vitin 2023.

DREJTORIA PËR KULTURË, RINI DHE SPORT

Shpenzimet në kategorinë e pagave, mallra&shërbime, shpenzimet komunale, subvencionet dhe investimet kapitale për 2023, 2024 dhe 2025




Shpenzimet e Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport përfshijnë katër kategori: pagat, mallrat, subvencionet dhe investimet kapitale. Dy kategori me pjesëmarrjen më të lartë të shpenzimeve të ndodhura në këtë drejtori janë: shpenzimet në kategorinë e Mallra&Shërbime dhe Investime Kapitale.

Shpenzimet në M&SH në tri vitet e fundit kanë pasur lëvizje të ndryshueshme. Në vitin 2024 janë shpenzuar rreth 476 mijë euro më shumë se në vitin 2023, ndërsa në vitin 2025 shpenzimet nga kjo kategori janë zvogëluar për rreth 188 mijë euro në raport me vitin 2024.

Po ashtu një kategori tjetër e rëndësishme e shpenzimeve janë investimet kapitale, të cilat janë rritur në tre vitet e fundit. Në vitin 2024 shpenzimet për investime kapitale ishin rritur me mbi 200 mijë euro më shumë krahasuar me vitin 2023, ndërsa në vitin 2025 shpenzimet për investime kapitale ishin pothuajse të njëjta krahasuar me vitin paraprak 2024.

DREJTORIA E PUNËS DHE MIRËQENIES SOCIALE

Shpenzimet në kategorinë e pagave, mallra&shërbime, shpenzimet komunale, subvencionet dhe investimet kapitale për 2023, 2024 dhe 2025




Në Drejtorinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale ajo që vërehet më shumë janë shpenzimet në kategorinë e Mallra&Shërbimeve, Investimeve Kapitale dhe Pagave.

Shpenzimet në kategorinë e M&SH përgjatë tri viteve të fundit 2023, 2024 dhe 2025 edhe pse në nivele të larta nuk kanë pasur shumë ndryshime duke mbetur pothuajse në nivelin e njëjtë të shpenzimeve, ndërsa ajo që vërehet më shumë për ndryshime më të mëdha në shpenzime janë Investimet Kapitale. Në vitin 2025 këto shpenzime ishin për rreth 445 mijë euro më shumë se në vitin 2023 me vlerë totale prej 584,669 mijë eurove, ndërsa në vitin 2024 këto shpenzime kapnin vlerën prej 580,394 euro.

DREJTORIA KOMUNALE E ARSIMIT

Shpenzimet në kategorinë e pagave, mallra&shërbime, shpenzimet komunale, subvencionet dhe investimet kapitale për 2023, 2024 dhe 2025




Shpenzimet në kategorinë e pagave janë ato që e karakterizojnë Drejtorinë e Arsimit, duke mos i anashkalluar edhe shpenzimet për investime kapitale.

Nga të dhënat në grafik shohim se shpenzimet për paga janë rritur nga viti 2023 deri në vitin 2025 me një ritëm të përafërt. Në vitin 2025 shpenzimet për paga kapin vlerën e rreth 20.5 milion eurove apo 1.2 milion euro më shumë se në vitin 2024, shprehur në përqindje rreth 6.16% më shumë. Ndërsa në raport me vitin 2023, shpenzimet për paga në vitin 2025 ishin më të larta për rreth 2.6 milion euro më shumë apo 14.5% më shumë shpenzime. Këto shpenzime të larta janë si pasojë e një numri të konsiderueshëm të mësimdhënësve e cila ndikon që të rriten shpenzimet për paga më shumë krahasuar me drejtoritë tjera komunale.

Shpenzimet për investime kapitale në vitin 2023, 2024 dhe 2025 kanë mbetur pothuajse të njëjta me rreth 2.37 milion euro në secilin vit.

DREJTORIA SHËNDETËSISË

Shpenzimet në kategorinë e pagave, mallra&shërbime, shpenzimet komunale, subvencionet dhe investimet kapitale për 2023, 2024 dhe 2025




Pjesën dërmuese të shpenzimeve në Drejtorinë e Shëndetësisë e zënë shpenzimet në kategorinë e pagave, kjo për arsye që numri i punonjësve është më i madh krahasuar me drejtoritë tjera komunale duke përjashtuar drejtorinë e arsimit. Nga të dhënat e analizuara shihet që shpenzimet për paga kanë pasur rritje të theksuar nga viti 2023 deri në vitin 2025. Në vitet 2023 dhe 2024 shpenzimet për paga pothuajse ishin konstante në këtë drejtori me 4.6 përkatësisht 4.5 milion euro. Ndërsa në vitin 2025 këto shpenzime ishin rritur për rreth 600 mijë euro krahasuar me vitin paraprak 2024. Po ashtu edhe shpenzimet në kategorinë Mallra&Shërbime dhe Investime kapitale shihet se janë rritur dukshëm nga viti 2023 deri në vitin 2025.

Shpenzimet me nivelin më të ulët janë ato të shpenzimeve komunale (komunalitë) të cilat në vitin 2024 janë më pak krahasuar me vitet 2023 dhe 2025.

SHPENZIMET SIPAS KATEGORIVE EKONOMIKE NË NIVEL KOMUNAL PËR TRE VIETET PARAPRAKE 2025, 2024 DHE 2023

Shpenzimet në kategorinë e pagave, mallra&shërbime, shpenzimet komunale, subvencionet dhe investimet kapitale për 2023, 2024 dhe 2025



Përveç shpenzimeve komunale (komunalitë) në nivel komunal, të gjitha kategoritë tjera të shpenzimeve në Komunën e Prizrenit janë rritur vazhdimisht vit pas viti.

- Shpenzimet në kategorinë e paga përbëjnë pjesën më të madhe të shpenzimeve të përgjithshme në secilin vit. Në vitin 2025 këto shpenzime ishin në vlerë prej rreth 29.8 milion euro apo rreth 2.4 milion euro më shumë se në vitin 2024, shprehur në përqindje rreth 8.7 %. Ndërsa në raport me vitin 2023 shpenzimet e pagave ishin më të larta në vitin 2025 për rreth 4.1 milion euro apo rreth 15.9% më shumë.
- Në kategorinë Mallra&Shërbime shpenzimet po ashtu ishin në rritje të vazhdueshme në tri vitet e fundit. Në vitin 2025 këto shpenzime kapnin vlerën e rreth 14.3 milion euro apo 1.8 milion euro më shumë se në vitin 2024 apo rreth 14.4 %. Ndërsa në raport me vitin 2023 shpenzimet në këtë kategori në vitin 2025 ishin më të larta për rreth 2.5 milion euro më shumë apo 21 %.

- Po ashtu rritje të shpenzimeve kishte edhe në kategorinë e subvencioneve, në vitin 2025 shpenzimet për subvencione ishin në vlerë prej rreth 4.75 milion euro apo rreth 600 mijë euro më shumë se në vitin 2024, shprehur në përqindje rreth 14.7 % më shumë. Ndërsa në raport me vitin 2023, shpenzimet për subvencione në vitin 2025 ishin më të larta për rreth 1.2 milion euro krahasuar me vitin 2023 apo shprehur në përqindje rreth 34.45 % më shumë shpenzime.
- Tek kategoria e shpenzimeve për Investime Kapitale ka luhetje të vlerave të shpenzimeve. Në vitin 2024 shpenzimet për investime kapitale kapnin vlerën prej 23.8 milion euro apo rreth 4.6 euro më shumë krahasuar me vitin 2023 apo shprehu në përqindje rreth 24 % më shumë shpenzime, ndërsa vitin 2025 shpenzimet për investime kapitale ishin zvogëluar për rreth 830 mijë euro në raport me vitin 2024 apo shprehur në përqindje rreth 3.5 % më pak shpenzime. Por krahasuar me vitin 2023, në vitin 2025 kishte më shumë shpenzime në kategorinë e investimeve kapitale për rreth 3.8 milion euro më shumë apo shprehur në përqindje rreth 19.6%.